



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.7

2004

25 shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9172 datë 29.1.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar në projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë, II-viti 2001".....	197
Ligj nr.9173 datë 29.1.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar në projektin "Fondi i investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore".....	199
Ligj nr.9174 datë 29.1.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar (Fondi i studimeve dhe i specialistëve, V-viti 2001).....	201
Ligj nr.9175 datë 29.1.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për financimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës Vorë-Rinas-Fushë-Krujë".....	203

Ligj nr.9179 datë 29.1.2004	Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake.....	212
Vendim i Kuvendit nr.120, datë 12.2.2004	Për zgjedhjen e një anëtari në Komisionin e Konkurrencës	215
Dekret nr.4128 datë 17.2.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	215
Vendim i KM nr.69, datë 29.1.2004	Për kriteret dhe masën e pagesës për t'u përjashtuar nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe për disa ndryshime në vendimin nr.244, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave "Për masën e pagesës për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv, si dhe për trajtimin e ushtarëve me pagesë"	216
Vendim i KM nr.74, datë 12.2.2004	Për miratimin e rregullave për indeksimin e pagave	217
Vendim i KM nr.77, datë 12.2.2004	Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Akreditimit	219
Vendim i KM nr.78, datë 12.2.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.404, datë 19.6.2003 "Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Bordit të Gjeoinformacionit"	220
Vendim i KM nr.80, datë 12.2.2004	Për pagesën e mjekëve, anëtarë të komisioneve mjekësore të kontrollit të aftësive për shërbimin ushtarak	220
Vendim i KM nr.81, datë 12.2.2004	Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore.....	221

L I G J
Nr. 9172, datë 29.1.2004

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR NË PROJEKTIN "FURNIZIMI ME UJË
DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË KRUIJË, II - VITI 2001"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar në projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë, II - viti 2001".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4131, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR**
(Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi prej gjithsej deri në 2 556 459,41 euro (dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë 41/100 euro) për projektin "Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II", ku nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2008.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në paragrafin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë në datën 22.9.2003 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

L I G J
Nr. 9173, datë 29.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR NË PROJEKTIN “FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE ADF-III-SHQIPËRIA VERIORE DHE LINDORE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar në projektin “Fondi i investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4132, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR
(Fondi i Investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare shqiptaro-gjermane të datës 5 dhjetor 2001, u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, shumat e mëposhtme:

1) një hua me vleftë prej gjithsej deri 2 301 000 euro (dy milionë e treqind e një mijë euro) për projektin "Fondi i investimeve sociale ADF-III-Shqipëria Veriore dhe Lindore";

2) një shumë financimi me vleftë prej gjithsej deri 256 000 euro (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në pikën 1.

U konstatua se projekti në tërësi vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projektet e përmendura në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me projekte të tjera. Në qoftë se projektet e përmendura në paragrafin 1 do të zëvendësohen me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose një fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose një masë e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose një masë e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 pika 1, ose shuma të tjera financimi për masa të mëtejshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 pika 2, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masat përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikat 1 dhe 2, në rast se nuk përdoren për masa të tilla, do të kthehen në hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, si dhe marrësve të shumës së financimit, të cilët i nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 do të zhvleftësohet në rast se kontratat përkatëse për huanë dhe financimin nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumat në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2009.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau, për pretendimet e mundshme lidhur me kthimin e shumave, pretendime të cilat mund të ngrihen në bazë të kontratave të financimit që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e ligjit në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë në datën 22.9.2003 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

L I G J
Nr. 9174, datë 29.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR (FONDI I STUDIMEVE DHE I SPECIALISTËVE, V-VITI 2001)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar (Fondi i studimeve dhe i specialistëve, V-viti 2001)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4133, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHPUNIM FINANCIAR (Fondi i studimeve dhe i specialistëve V-viti 2001)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001;

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi prej gjithsej deri në 1 022 583,76 euro (një milion e njëzet e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre 76/100 euro) për ngritjen e një fondi studimesh dhe specialistësh ("Fondi i studimeve dhe i specialistëve V").

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundojë Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundojë brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2009.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundojë sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në paragrafin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë në datën 22.12.2003 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

L I G J
Nr. 9175, datë 29.1.2004

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM, PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS VORË-RINAS-
FUSHË-KRUJË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për financimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës Vorë-Rinas-Fushë-Krujë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4134, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**HUAJE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE
PËR ZHVILLIM PËR PJESËMARRJE NË FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS VORË-RINAS-FUSHË-KRUJË**

Kjo Marrëveshje bëhet në datën 02/08 1423H, që i korrespondon 28.9.2003, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (e quajtur këtej e tutje "Huamarrësi") nga njëra anë dhe Bankës Islamike për Zhvillim nga ana tjetër (referuar këtej e tutje "Banka"),

Ndërsa:

A) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës ta ndihmojë në financimin e pjesëshëm të kostos së projektit të rikonstruksionit të rrugës Vorë-Rinas-Fushë-Krujë (këtu e më poshtë i quajtur "Projekti") siç përshkruhet në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje, duke dhënë një hua siç parashikohet më poshtë.

B) Një nga qëllimet e Bankës është të ndihmojë vendet anëtare të saj nëpërmjet dhënies së huave për të financuar projekte dhe programe produktive.

C) Projekti është konsideruar teknikisht i qëndrueshëm, ekonomikisht dhe financiarisht i justifikuar.

D) Banka ka rënë dakord, ndër të tjera, që të akordojë kredinë sipas kushteve dhe termave të parashtruara më poshtë,

tani, rrjedhimisht palët këtu bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

Paragrafi 1.01 Kushtet e përgjithshme

Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme që i aplikohen Marrëveshjes së huasë e garancisë së Bankës, datë 8.11.1976 (më poshtë e quajtur "Kushtet e përgjithshme") me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur ato të ishin përcaktuar këtu.

Paragrafi 1.02 Përkufizimet

Termat e ndryshme të përdorura në këtë Marrëveshje, kudo ku ato përdoren, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, kanë të njëjtin kuptim me ato të përdorura dhe të përcaktuara në kushtet e përgjithshme, ndërsa termat shtesë kanë kuptimet që vijojnë:

a) "Data efektive" është data në të cilën Marrëveshja është deklaruar efektive nga Banka dhe i është komunikuar Huamarrësit nga ajo.

b) "Agjencia zbatuese" është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve pranë Ministrisë së Transporteve dhe të Telekomunikacionit, e cila është agjencia zbatuese përgjegjëse për zbatimin, funksionimin dhe menaxhimin e projektit.

c) "Projekti" dhe referenca "pjesët" nënkupton projektin dhe pjesët përbërëse të tij të përshkruara në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje.

d) "Dinari islamik/ID", siç është përcaktuar në nenin 4(1)(a) të Marrëveshjes për themelimin e Bankës, është njësia bazë e kontabilitetit të Bankës. Një dinar islamik është ekuivalent me një të drejtë speciale tërheqjeje (SDR) të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Neni 2

Huaja

Paragrafi 2.01 Shuma

Banka është dakord t'i japë Huamarrësit, nga burimet e saj të zakonshme, një shumë e cila nuk e kalon shumën ekuivalente të 6 260 000 ID (gjashtë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë dinarë islamikë).

Paragrafi 2.02

Me përjashtim të rastit kur Banka do të bjerë dakord ndryshe, kontratat për mallra e shërbime për t'u financuar të kësaj huaje do të prokurohen në përputhje me procedurat e vendosura nga Banka. Në këtë kontekst, Huamarrësi do t'i bindet rregullave të konferencës islamike lidhur me bojkotimin e Izraelit.

Neni 3

Amortizimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesës

Paragrafi 3.01 Amortizimi

Huamarrësi do të kthejë principalin e huasë në 25 (njëzet e pesë) vjet, përfshirë këtu edhe 7 (shtatë) vjetët e periudhës pa pagesë duke filluar nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta dhe të njëpasnjëshme çdo 6 (gjashtë) muaj, siç është parashikuar në aneksin 1(A) të kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 3.02 Tarifa e shërbimit

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një tarifë shërbimi në shumën që është vlerësuar fillimisht 642 088 ID (gjashtëqind e dyzet e dy mijë e tetëdhjetë e tetë dinarë islamikë), në përputhje me sa është parashikuar në aneksin I(B) të kësaj Marrëveshjeje.

Të dyja palët janë marrë vesh dhe kanë rënë dakord se shuma fillestare e tarifës së shërbimit e përcaktuar në nënparagrafin 3.02(a) këtu e më sipër, nuk është veçse një vlerësim i bazuar në parashikimin e periudhës së zbatimit dhe periudhës së livrimit të të gjithë shumës së huasë, siç është parashikuar më sipër.

Është rënë dakord më tej që shuma aktuale e tarifës së shërbimit do të llogaritet pas zbatimit të projektit, me kusht që shuma aktuale e llogaritur në këtë mënyrë nuk do të kalojë më shumë se 2.5% të shumës së huasë në vit.

c) Tarifa e shërbimit do të rrjedhë që nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 3.03 Vendet e kryerjes së pagesave

Të gjitha pagesat, përfshirë këtu edhe kthimin e principalit, do të konsiderohen të kryera siç duhet, kur fondet që përbëjnë këto pagesa të jenë kredituar në llogarinë e caktuar për këtë qëllim nga Banka.

Paragrafi 3.04

Pa rënë ndesh me klauzolat e përgjithshme të seksionit 3.03, të gjitha pagesat do të konsiderohen të kryera siç duhet:

a) Nëse pagesat do të bëhen në dollarë amerikanë, ku njëra nga Bankat që vijojnë i konfirmon Bankës Islamike për Zhvillim kryerjen e pagesës në llogarinë e saj pranë kësaj Banke;

i) Nr. i llogarisë 159111

Gulf International Bank (UK) Limited (GIB)

One Knightsbridge

London SW1X 7XS

United Kingdom

Telex nr. 8812261/2 SAUDI G

SWIFT CODE: SINTGB2L

ii) Nr. i llogarisë B10507

Arab Banking Corporation

P.O Box: 5698, Manama, Bahrain

Numrat teleks: 9385, 9431/2/3/, 9442 ABCBAH BN.

b) Nëse pagesat do të bëhen në stërlina, kur njëra nga bankat që vijojnë i konfirmon Bankës Islamike për Zhvillim kryerjen e pagesës në llogarinë e saj pranë kësaj Banke;

Nr. i llogarisë 122432 GBP2520 01

Gulf International Bank B.S.C.

75 King William Street

London EC4N 7DX

Mbretëria e Bashkuar

Telex No. 8812889 / 8813326 GIBANK G

SWIFT CODE: GULFGB 2L

c) Nëse pagesat do të bëhen në euro, kur njëra nga bankat që vijojnë i konfirmon Bankës Islamike për Zhvillim kryerjen e pagesës në llogarinë e saj pranë kësaj Banke;

Nr. i llogarisë 096965 001 51

Union De Banques Arabes et Francaises (UBAF)

92523 Paris, Neuilly Cedex

Francë

Telex No. 610334 UBAF

SWIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 4

Tërheqjet dhe përdorimi i fondeve të kredisë

Paragrafi 4.01 Tërheqjet

Shuma e huasë mund të tërhiqet nga Huamarrësi, sipas aneksit III dhe kushteve të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurave të disbursimit të Bankës për qëllimet e parashtruara në këtë Marrëveshje, për shpenzime të kryera në përputhje me kostot e justifikuar për mallrat dhe shërbimet e kërkuara për projektin dhe të rëna dakord për t'u financuar nga kjo Marrëveshje.

Paragrafi 4.02 Data e kërimit të disbursimit të parë

Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data efektive apo nga një datë tjetër të mëvonshme, siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi nuk ka paraqitur në Bankë një kërkesë për kryerjen e disbursimit të parë, Banka mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar rregullisht Huamarrësin.

Paragrafi 4.03 Data e përfundimit

Data 31.12.2005 ose një datë e mëvonshme, siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, është data e përfundimit të tërheqjeve të huasë sipas paragrafit 6.03(c) të kushteve të përgjithshme.

Paragrafi 4.04 Përdorimi i fondeve të kredisë

Të gjitha shumat e tërhequra nga Huamarrësi prej llogarisë së huasë do të përdoren vetëm për qëllimet e projektit të financuar nga Banka.

Neni 5

Zbatimi i projektit

Paragrafi 5.01 Huamarrësi merr përsipër:

a) Të zbatojë projektin dhe të drejtojë veprimtarinë dhe punimet përmes agjencisë zbatuese me efikasitetin dhe angazhimin e duhur dhe në përputhje me praktikën e qëndrueshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike nën mbikëqyrjen dhe administrimin e një personeli të kualifikuar dhe në përputhje të plotë me planin e investimeve, buxhetin, planet dhe specifikimet që kanë të bëjnë me projektin, të dorëzuar dhe të aprovuar nga Banka.

b) T'i paraqesë Bankës për miratim, në mënyrë të detajuar, ashtu siç mund të kërkojë Banka, çdo modifikim të rëndësishëm të parashikuar për buxhetin, planet dhe specifikimet e projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në çdo kontratë për shërbime apo prokurim mallrash lidhur me zbatimin e projektit.

Paragrafi 5.02

Pa vendosur asnjë detyrim apo kufizim tjetër mbi obligimet e Marrëveshjes, Huamarrësi duhet t'i lejojë Bankës një afat kohor të pranueshëm për të komentuar mbi ndryshimet thelbësore ose ndonjë shtrirje të kohës së kushtëzuar në ndonjë kontratë për shërbime apo prokurim mallrash gjatë zbatimit të projektit.

Neni 6

Kërkesa paraprake shtesë para livrimit nga Banka

Para paraqitjes së kërkesës së parë për tërheqje, Huamarrësi duhet të tregojë procedurën që ai propozon të ndiqet apo rastet që duhet t'i nënshtrohen tenderimit konkurrues ndërkombëtar, në pajtim me paragrafin 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje dhe të marrë për këtë aprovimin e Bankës.

Neni 7

Klauzola të veçanta

Paragrafi 7.01

Huamarrësi duhet të vërë në dispozicion, menjëherë sapo të kërkohet, të gjitha shumat këtu edhe kostot në monedhë lokale, kostot e tejkaluara që do të nevojiten për realizimin e projektit, në afate dhe kushte të kënaqshme për Bankën.

Paragrafi 7.02

Me përjashtim të rastit kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi do të lidhë të gjitha kontratat për punimet civile të financuara nga të ardhurat e kësaj huaje për ekzekutimin e projektit, nëpërmjet tenderimit konkurrues ndërkombëtar ndërmjet kontraktorëve të parakualifikuar nga firmat e vendeve anëtare të Bankës. Auditimi financiar dhe teknik do të prokurohet mbi bazën e tenderimit konkurrues lokal dhe PMU do të zgjidhet nga agjencia zbatuese, subjekt i miratimit të Bankës dhe do të kërkohet miratimi paraprak i Bankës për lidhjen e çdo kontrate, vlera e së cilës tejkalon shumën ekuivalente të 150 000 ID (njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë).

Paragrafi 7.03

Huamarrësi do t'i vërë në dispozicion Bankës, menjëherë pas miratimit të tyre nga Huamarrësi, studimet, planet dhe specifikimet për projektin, programin e zbatimit të tij dhe çdo modifikim material të kryer më pas, në detaje siç do të kërkohet nga Banka herë pas here.

Paragrafi 7.04

Huamarrësi do të krijojë dhe të mbajë të dhëna të përshtatshme për të identifikuar mallrat e financuara nga fondet e huasë, për të evidentuar përdorimin e tyre në projekt, për të regjistruar progresin e projektit dhe për të reflektuar në përputhje me praktikën kontabël të mbajtura në mënyrë të plotë e të vazhdueshme, operacionet dhe situatën financiare të agjencisë zbatuese.

Paragrafi 7.05

Huamarrësi do të krijojë të gjitha mundësitë për përfaqësuesit e akredituar të Bankës për të kryer vizita për qëllime që lidhen me huanë, si dhe për të inspektuar projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe të dhënë përkatëse; dhe do t'i japë Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me shpenzimin e të ardhurave të huasë, projektin, mallrat dhe veprimtarinë, si dhe gjendjen financiare të agjencisë zbatuese.

Paragrafi 7.06

Në funksion të realizimit dhe funksionimit të projektit, Huamarrësi merr përsipër të marrë të gjitha masat e duhura që agjencia zbatuese në çdo kohë të funksionojë sipas rregullores, në formë e në përmbajtje të kënaqshme për Bankën dhe të ketë pushtetin e nevojshëm për menaxhimin dhe administrimin eficient të projektit.

Paragrafi 7.07

Huamarrësi do të sigurojë ose do të detyrohet të sigurojë, nëpërmjet një shoqërie sigurimi me reputacion, të gjitha mallrat e financuara nga fondet e huasë. Një sigurim i tillë do të mbulojë rreziqet aksidentale detare, transitet apo të tjera rreziqe gjatë blerjes dhe importimit të mallrave në territorin e Huamarrësit dhe livrimin të tyre deri në zonën e projektit dhe do të jetë në shuma që janë në përputhje me ligjet e Huamarrësit, me mirëkuptimin që mallrat do të sigurohen me një kompani që do të paguajë të ardhurat e sigurimit në valutë të huaj.

Paragrafi 7.08

Huamarrësi do të marrë të gjitha masat që gjykohen të nevojshme për të vënë në dispozicion, si dhe kur do të nevojiten të gjitha të drejtat dhe pronësinë mbi tokën, siç do të kërkohet për realizimin e projektit dhe do t'i japë Bankës, me kërkesën e saj, evidencën e plotë për sigurimin e këtyre të drejtave dhe pronësisë lidhur me tokën të vënë në dispozicion të projektit.

Paragrafi 7.09

Huamarrësi do të ndërmarrë të gjitha masat, që do të jenë të nevojshme nga ana e tij, për të mundësuar agjencinë zbatuese që do të zbatojë projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose të lejojë të ndërmerret ndonjë veprim i cili do ta pengonte apo ndërhynte në zbatimin ose ecurinë e projektit apo në respektimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 7.10

Të gjitha dokumentet bankare, të dhënat, korrespondenca dhe materialet e njëjta do të konsiderohen nga Banka dhe Huamarrësi çështje konfidenciale.

Neni 8 Raportet

Paragrafi 8.01

a) Huamarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë për të siguruar plotësimin e qëllimeve të huasë. Për këtë qëllim, secili do t'i japë tjetrit informacionin e kërkuar lidhur me gjendjen e përgjithshme të huasë. Nga ana e Huamarrësit ky informacion do të përfshijë kushtet ekonomike, financiare të territorit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Huamarrësit.

b) Huamarrësi dhe Banka herë pas here, me kërkesën e secilës prej palëve, do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre përmes përfaqësuesve të tyre, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me huanë, mirëmbajtjen e shërbimeve dhe realizimin nga Huamarrësi të detyrimeve të tij në këtë Marrëveshje.

Paragrafi 8.02

a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë paraqitjen ose të ngarkojë të tjerë që t'i paraqesin Bankës me pëlqimin e plotë të saj, në kohën e specifikuar për secilin, raportet që vijojnë:

i) Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendari ose brenda një periudhe kohore tjetër, siç mund të bien dakord palët, raporte mbi zbatimin e projektit në mënyrën që Banka herë pas here mund të specifikojë;

ii) Raporte të tjera që Banka në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë, lidhur me investimin e shumave të huasë së akorduar dhe progresin e arritur nga projekti;

iii) Menjëherë pas përfundimit të projektit, për çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj nga data e mbylljes ose në një datë të mëvonshme siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport përfundimi, sipas qëllimit dhe detajeve që do të kërkojen nga Banka, mbi zbatimin dhe veprimtarinë fillestare të projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë paragraf do të vërtetohen me zgjedhjen e Bankës, në atë mënyrë që do të kërkohet prej saj.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi vetëm pasi:

A) 1. Bankës t'i jetë dhënë evidenca e kënaqshme që zbatimi dhe livrimi i kësaj Marrëveshjeje nga ana e Huamarrësit është autorizuar siç duhet apo është ratifikuar nga të gjitha instancat qeveritare të nevojshme.

2. Huamarrësi t'i ketë dhënë Bankës një opinion ligjor të pranueshëm të lëshuar nga një autoritet ligjor qeveritar, që deklaron se Marrëveshja e huasë është autorizuar dhe nënshkruar rregullisht nga ana e Huamarrësit. Deklarata duhet të pohojë që Marrëveshja përbën një detyrim lidhës për Huamarrësin në përputhje me afatet e saj.

B) Ministria e Financave ose një organ tjetër qeveritar i autorizuar të lëshojë për Bankën Qendrore ose çdo njësi tjetër që kryen funksionet e një banke qendrore duke e udhëzuar atë që pagesa e kësteve të huasë sipas kësaj Marrëveshjeje dhe e taksës së shërbimit, të kryhet nga Banka Qendrore apo njësi që kryen funksionet e një banke qendrore brenda datave të përcaktuara. Huamarrësi duhet t'i dërgojë Bankës një kopje të kësaj letre autorizimi së bashku me pranimin nga ana e Bankës Qendrore ose e njësisë që kryen funksionet e një banke qendrore, që njofton se është marrë letra e autorizimit e cituar më sipër dhe se do t'i përmbahet udhëzimeve që përmban ajo.

C) Të gjitha kushtet e mësipërme duhet të përmbushen para se Huamarrësit t'i lindë e drejta për të përfutur fondet e kësaj kredie.

Neni 10
**Përfundimi i Marrëveshjes për shkak
të moshyrjes në fuqi**

Në rast se Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi deri më 30.6.2004 (vendoset një datë që bie 18 muaj pas datës së miratimit), Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve këtu më sipër do të përfundojnë, me përjashtim të rastit kur Banka, pasi të ketë marrë parasysh të gjithë arsyet e vonesës, do të përcaktojë një datë të mëvonshme për zbatimin e këtij neni. Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11
Dispozita të ndryshme

Paragrafi 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar

Ministri i Financave i Huamarrësit dhe çdo person apo personat që ai do të emërojë me shkrim do të konsiderohen përfaqësues të autorizuar të Huamarrësit në funksion të paragrafit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Paragrafi 11.02 Data e Marrëveshjes

Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që do të deklarohet në parathënieën e saj.

Paragrafi 11.03 Adresat

Adresat e mëposhtme janë përcaktuar në funksion të paragrafit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax: ++ 355 (4) 362 581

Për Bankën Islamike të Zhvillimit:
Kutia postare 5925
Jeddeh 21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Telex: 601137 ISDB SJ
Telefax: 6366871
Cable: BANKISLAMI JEDDAH

Para dëshmitarëve, Banka dhe Huamarrësi, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, në datën dhe vitin e lartshënuar.

Për dhe në emër të Qeverisë Shqiptare

Z. Kastriot ISLAMI
Ministër i Financave

Për dhe në emër të Bankës Islamike
për Zhvillim

Dr. Amadou Boubacar Cisse
Zv/President

ANEKSI I (A)

SHLYERJA E PRINCIPALIT

Vendi: Qeveria e Shqipërisë
 Projekti: Rikonstruksioni i rrugës Vorë-Rinas-Fushë-Krujë
 Shuma e kredisë: 6 260 000 ID (dinarë islamikë)
 Afati i kredisë: 25 vjet
 Periudha pa pagesë: 7 vjet
 Tarifa e shërbimeve: 642 088 ID (dinarë islamikë)

NUMRI	DATA	PAGESA E PRINCIPALIT ID
1	31/12/10	173,889
2	30/06/11	173,889
3	31/12/11	173,889
4	30/06/12	173,889
5	31/12/12	173,889
6	30/06/13	173,889
7	31/12/13	173,889
8	30/06/14	173,889
9	31/12/14	173,889
10	30/06/15	173,889
11	31/12/15	173,889
12	30/06/16	173,889
13	31/12/16	173,889
14	30/06/17	173,889
15	31/12/17	173,889
16	30/06/18	173,889
17	31/12/18	173,889
18	30/06/19	173,889
19	31/12/19	173,889
20	30/06/20	173,889
21	31/12/20	173,889
22	30/06/21	173,889
23	31/12/21	173,889
24	30/06/22	173,889
25	31/12/22	173,889
26	30/06/23	173,889
27	31/12/23	173,889
28	30/06/24	173,889
29	31/12/24	173,889
30	30/06/25	173,889
31	31/12/25	173,889
32	30/06/26	173,889
33	31/12/26	173,889
34	30/06/27	173,889
35	31/12/27	173,889
36	30/06/28	173,885
TOTAL		6,260,000

ANEKSI I (B)

PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Vendi:	Qeveria e Shqipërisë
Projekti:	Rikonstruksioni i rrugës Vor-Rinas-Fushë-Krujë
Shuma e kredisë:	6 260 000 ID (dinarë islamike)
Afati i kredisë:	25 vjet
Periudha pa pagesë:	7 vjet
Taksa e shërbimeve:	642 088 ID (dinarë islamikë)

NUMRI	DATA	TARIFA E SHËRBIMIT ID
1	30/06/2004	25,684
2	31/12/2004	42,806
3	30/06/2005	42,806
4	31/12/2005	42,806
5	30/06/2006	42,806
6	31/12/2006	42,806
7	30/06/2007	42,806
8	31/12/2007	35,957
9	30/06/2008	35,957
10	31/12/2008	35,957
11	30/06/2009	35,957
12	31/12/2009	35,957
13	30/06/2010	35,957
14	31/12/2010	35,957
15	30/06/2011	35,957
16	31/12/2011	35,957
17	30/06/2012	35,955
TOTAL		642,088

ANEKSI II

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti kryesor i projektit është rikonstruksioni dhe përmirësimi i seksionit rrugor Vorë-Rinas-Fushë-Krujë, me një gjatësi prej 11.1 km, që ishte dëmtuar rëndë gjatë krizës kosovare, me qëllim që të përballojë më mirë trafikun ekzistues, si dhe parashikimet e ardhshme të trafikut rrugor.

Projekti përfshin punime civile (rikonstruksionin dhe përmirësimin e segmentit rrugor Vorë-Rinas-Fushë-Krujë) me një gjatësi prej 11.1 km. Shërbimet e konsulencës dhe të mbikëqyrjes, njësisë së menaxhimit të projektit, auditimit financiar dhe teknik, shpronësimet dhe fondet rezervë (rezervat materiale dhe për çmimet).

ANEKSI III

TËRHEQJA E FONDEVE TË HUASË

Fondet e huasë së Bankës Islamike për Zhvillim prej 6.26 milionë ID (afërsisht rreth 8.145 milionë USD) do të përdoren për financimin e komponentëve, siç përcaktohen si më poshtë në planin financiar:

Plani i propozuar financiar

Përshkrimi	Huaja e Bankës Islamike	Qeveria shqiptare	Kosto totale
1 - Punime civile	6,840 (huaja e propozuar)	0,760	7,600
2 - Shërbime konsulence	0,380	-	0,380
3 - Njësia e menaxhimit të Projektit	0,130	-	0,130
4 - Auditimi financiar dhe teknik	0,050	-	0,050
5 - Shpronësimet	-	0,520	0,520
6 - Seminar për fillimin e projektit	0,005	-	0,005
Nën totali	7,405	0,128	0,685
Fondet kontigjencë	0,740	0,128	0,868
TOTALI	8,145	1,408	9,553
Përqindja e financimit	85,3 %	14,7 %	100 %

L I G J

Nr. 9179, datë 29.1.2004

PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE, QË KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRIË USHTARAKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj përcakton mënyrën, masën, procedurat e përfitimit të trajtimit të veçantë dhe kontributin e sigurimeve shoqërore për punonjësit, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i një trajtimi të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, kur plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Bazë e vlerësuar" është paga, sipas së cilës janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore nga data 1.1.1994 deri në ditën e fundit të lënies së punës.

2. "Periudhë gatishmërie" është periudha gjatë së cilës punonjësi është paguar me një pagë gatishmërie, me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore.

3. "Periudhë sigurimi" është periudha gjatë së cilës punonjësi ka qenë në marrëdhënie pune, si dhe janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore.

4. "Periudhë pune" është periudha gjatë së cilës punonjësi ka qenë në marrëdhënie pune në ndërmarrjet përkatëse ushtarake dhe periudha që është trajtuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.389, datë 8.8.2002 "Për trajtimin e punonjësve, që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të Uzinës Mekanike Gramsh" dhe nr.695, datë 27.12.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.766, datë 8.12.1998 "Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike ushtarake të rëndësisë së veçantë".

5. "Veprimtari ekonomike" është ushtrimi i çdo lloj veprimtarie, në të cilën personat janë në marrëdhënie si punëdhënës, të punësuar ose të vetëpunësuar, me përjashtim të atyre personave, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi.

Neni 4

Përfitojnë trajtim të veçantë punonjësit e ndërmarrjeve të sistemit të industrisë ushtarake, të cilët:

- në datën 31.12.2002 kanë qenë në marrëdhënie pune ose janë trajtuar në bazë të vendimeve nr.389, datë 8.8.2002 dhe nr.695, datë 27.12.2002 të Këshillit të Ministrave në Kombinatin Mekanik në Poliçan, në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës, në Uzinën Mekanike dhe Uzinën e Pilave në Gramsh dhe në Uzinën e Riparimit të Avionëve në Kuçovë;

- kanë një periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 15 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 18 vjet për gratë dhe periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 18 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet për burrat;

- nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike.

Neni 5

Masa e përfitimit për këta punonjës është e barabartë me 70 për qind të bazës së vlerësuar, por jo më shumë se pensioni maksimal.

Në rastet kur për llogaritjen e bazës së vlerësuar mungojnë dokumentet përkatëse, masa e përfitimit minimal përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

E drejta e kërkesës për përfitime, sipas këtij ligji, ushtrohet nga subjektet që përfitojnë deri në datën 30.9.2004.

Neni 7

Të gjithë personat, që përfitojnë trajtim të veçantë, sipas këtij ligji, kanë të drejtë ta marrin atë, deri në çastin e lindjes të së drejtës së një përfitimi nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" ose deri kur ata bëhen ekonomikisht aktivë.

Neni 8

Masa e këtij trajtimi do të indeksohet në vite, në përputhje me atë të pensioneve të pleqërisë.

Neni 9

Personat, të cilët përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimeve shoqërore, përjashtohen nga përfitimet, sipas këtij ligji, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

Neni 10

Të gjithë ata punonjës, që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të ndërmarrjeve, prodhuese dhe riparuese, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nuk përfitojnë nga ky ligj, trajtohen për një vit me pagë, sipas vendimeve nr.389, datë 8.8.2002 dhe nr.695, datë 27.12.2002 të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Mënyra e llogaritjes, caktimit dhe pagimit të përfitimeve, që rrjedhin nga ky ligj dhe pagesa e komisionit kundrejt të cilës Instituti i Sigurimeve Shoqërore kryen këto shërbime, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Periudha gjatë së cilës punonjësit përfitojnë trajtim të veçantë vlerësohet periudhë sigurimi dhe kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 10 dhe 11 të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4138, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 120, datë 12.2.2004

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI NË KOMISIONIN E KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Zef Preçi zgjidhet anëtar i Komisionit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

DEKRET
Nr. 4128, datë 17.2.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Bardhyl Novrus Çelaj | 19. Enika Shkëlzen Resuli |
| 2. Vera Arif Çelaj (Vezelaj) | 20. Asllan Shkëlzen Resuli |
| 3. Gjylsjana Bardhyl Çelaj | 21. Jaus Fiqiret Zaganjori |
| 4. Liri Nexhip Manaj (Balli) | 22. Altin Fatmir Sorra |
| 5. Joana Arben Manaj | 23. Aziz Metin Ruli |
| 6. Dario Arben Manaj | 24. Natasha Pali Ruli (Çekani) |
| 7. Shkëlqim Agron Kunz (Tomani) | 25. Andi Aziz Ruli |
| 8. Shpresa Xhevdet Cellmer (Haxho) | 26. Doris Aziz Ruli |
| 9. Renata Muhamet Bode | 27. Aurora Kujtim Zhegu |
| 10. Merjeme Abaz Neziri (Hysa) | 28. Blerim Xhaferr Rryçi |
| 11. Shaban Hasan Hasrama | 29. Jonela Petrit Hoxhaj |
| 12. Martin Qamil Langgaard | 30. Musa Rexhep Hoxha |
| 13. Arlinda Fatos Schmidtke (Cipi) | 31. Liridon Musa Hoxha |
| 14. Edmond Hamdi Leka | 32. Mirela Ismet Shkëmbi (Krasniqi) |
| 15. Ernest Ndoc Lukaj | 33. Etleva Hasan Theß (Ceka) |
| 16. Kajmak Hebib Karaj | 34. Nimete Skënder Vokopola |
| 17. Rilinda Ibrahim Resuli (Shaba) | 35. Tonin Pashko Ujka |
| 18. Amanda Shkëlzen Resuli | 36. Erand Dalip Shehi |

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 37. Maik Milto Garuli | 52. Fation Hajdar Sheqeri |
| 38. Enis Kujtim Garuli | 53. Dashurije Isa Kipping (Rexhepaj) |
| 39. Ilfiora Nevruz Çiba (Lika) | 54. Ernest Kozma Andoni |
| 40. Dylber Ismail Zorba | 55. Mariela Ernest Andoni |
| 41. Alban Astrit Cani | 56. Erwin Ernest Andoni |
| 42. Edvana Novruz Gjashta (Male) | 57. Miranda Qemal Andoni (Luca) |
| 43. Minjola Ded Hartmann (Pjetri) | 58. Engjëll Hamdi Mahilaj |
| 44. Stela Ramazan Karaj | 59. Eglantina Gjok Bossert (Frroku) |
| 45. Elona Samedin Khalaila (Gjini) | 60. Saimir Ali Kurti |
| 46. Arben Ali Abdihoxha | 61. Klarita Shehap Nestler (Lamaj) |
| 47. Andrea Todi Minga | 62. Lumturije Hysen Hoxha |
| 48. Aleksandra Theofan Minga (Sheshi) | 63. Iva Gëzim Hoxha |
| 49. Bleranda Andrea Minga | 64. Megi Gëzim Hoxha |
| 50. Eldiona Andrea Minga | 65. Amanda Gëzim Hoxha |
| 51. Gëzim Hasim Pushaj | 66. Denita Shpëtim Bisha |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 69, datë 29.1.2004

**PËR KRITERET DHE MASËN E PAGESËS PËR T'U PËRJASHTUAR NGA SHËRBIMI I
DETYRUESHËM USHTARAK DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.244,
DATË 20.4.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MASËN E PAGESËS PËR
PËRJASHTIMIN NGA SHËRBIMI I DETYRUESHËM USHTARAK AKTIV,
SI DHE PËR TRAJTIMIN E USHTARËVE ME PAGESË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 42 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtetasi shqiptar, i aftë dhe brenda moshës për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, mund të përjashtohet nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak kundrejt pagesës së një shume prej 300 000 (treqind mijë) lekësh.

2. Shtetasi shqiptar, i aftë dhe brenda moshës për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, që ka përfunduar shkollën e lartë universitare, me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit, mund të përjashtohet nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak kundrejt pagesës së një shume prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekësh.

3. Shtetasi që për shkak të kryerjes së dënimit me burgim, me vendim gjykatë të formës së prerë apo pa shkaqe ligjore, nuk e ka kryer të plotë shërbimin e detyrueshëm ushtarak, mund ta shlyejë periudhën e mbetur të këtij shërbimi me pagesë, e cila llogaritet sipas vlerës së pagesës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe periudhës së pakryer të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

4. Të ardhurat që do të realizohen nga zbatimi i këtij vendimi të ndahen si më poshtë vijon:
- 10 për qind Buxhetit të Shtetit;
- 90 për qind Ministrisë së Mbrojtjes, e cila t'i përdorë sipas vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

5. Në vendimin nr.244, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave "Për masën e pagesës për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv, si dhe për trajtimin e ushtarëve me pagesë", të bëhen këto ndryshime:

- Titulli i vendimit bëhet "Për trajtimin e ushtarëve me pagesë".
- Pikat 1 dhe 4 shfuqizohen.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 74, datë 12.2.2004

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR INDEKSIMIN E PAGAVE

Në mbështetje të pikave 2 dhe 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksi i pagave të bëhet një herë në vit, në përputhje me afatet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, brenda datës 31 mars të çdo viti, miraton masën e indeksimit të pagave.

2. Instituti i Statistikës (INSTAT), në janar të çdo viti, të deklarojë indeksin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit, vlerën e inflacionit vjetor që do të përdoret për indeksimin e pagave, si dhe vlerën e inflacionit vjetor, e cila të bazohet në një shportë më të reduktuar mallrash, që do të përdoret për indeksimin e pensioneve.

3. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, në dhjetor të vitit pararendës, të paraqesin në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale të dhënat për numrin e punonjësve dhe pagat e tyre, sipas strukturave përkatëse të pagave, të aparateve dhe të institucioneve të varësisë.

4. Organet e njësive të qeverisjes vendore, brenda kufijve, minimalë e maksimalë, të pagave, të miratuara e të indeksuara, të bëjnë indeksimin e pagave të punonjësve të tyre dhe të punonjësve të njësive ekonomike e institucioneve të varësisë, mbështetur në tabelat e pagave, të miratuara nga këshillat bashkiake, komunale dhe të qarqeve.

5. Ndërmarrjet shtetërore, që funksionojnë sipas ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe shoqëritë tregtare apo anonime, që funksionojnë sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të cilat në fund të vitit rezultojnë me humbje, brenda muajit janar të vitit gjatë të cilit do të bëhet indeksimi, të paraqesin në ministrinë e linjës, nga e cila varen, të dhënat për numrin e punonjësve dhe pagat e tyre.

6. Indeksi i pagave të bëhet si më poshtë vijon:

a) Për nëpunësit civilë, punonjësit apo funksionarët e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, të cilët trajtohen në pagë, sipas strukturës së pagave të nëpunësve civilë, të indeksohen paga e grupit dhe shtesa e pozicionit.

b) Për punonjësit, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjes I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit" të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të indeksohet paga fikse e miratuar në këtë lidhje.

c) Për punonjësit, të cilët trajtohen në pagë sipas sistemit të pagave me klasa, të indeksohet paga bazë për klasë.

ç) Për punonjësit në strukturat e Policisë së Shtetit, të cilët trajtohen në pagë sipas sistemit pagë-gradë, të indeksohet paga bazë për gradë.

d) Për punonjësit në strukturat e Forcave të Armatosura, të cilët trajtohen në pagë sipas sistemit pagë-gradë, të indeksohet paga bazë për gradë.

dh) Për punonjësit në strukturat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, deri në njësimin e pagave të tyre me strukturat e Policisë së Shtetit, për aq kohë sa ata do të trajtohen me sistemin e pagave me 22 klasa, të indeksohet paga bazë për klasë. Me kalimin në sistemin e pagave paga-gradë, të indeksohet paga bazë për gradë.

e) Për punonjësit në strukturat e Policisë së Burgjeve, deri në njësimin e pagave të tyre me strukturat e Policisë së Shtetit, për aq kohë sa ata do të trajtohen me sistemin e pagave me 22 klasa, të indeksohet paga bazë për klasë. Me kalimin në sistemin e pagave pagë-gradë, të indeksohet paga bazë për gradë.

ë) Për punonjësit e organeve të qeverisjes vendore:

i) Kur janë funksionarë të zgjedhur, të indeksohen kufijtë e pagave të miratuara në pikën 9 të vendimit nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave.

ii) Kur janë nëpunës civilë, të indeksohen paga e grupit dhe kufijtë, minimalë e maksimalë, të shtesës për pozicion, të miratuara në lidhjet nr.1, 2 dhe 3 të vendimit nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave.

iii) Do të indeksohen dhe kufijtë e miratuar në pikat 15 e 16 të vendimit nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave.

f) Për ndërmarrjet shtetërore, sipas nenit 2 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të indeksohet paga minimale. Ndërmarrjet ta bëjnë vetë indeksimin e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufijve të miratuar e të indeksuar.

g) Ndërmarrjet shtetërore, që funksionojnë sipas ligjeve nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të cilat në fund të vitit rezultojnë me humbje dhe subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, jo për diferencën e çmimeve, të indeksojnë pagat e punonjësve, pas miratimit nga ministritë përkatëse, të cilat shqyrtojnë programet financiare të tyre dhe caktojnë fondin e pagave për periudhën përkatëse.

7. Efektet financiare të indeksimit të pagave, për shkak të ndryshimit të indeksit të çmimeve, për institucionet buxhetore, të përballohen nga Buxheti i Shtetit, i miratuar për çdo institucion, ndërsa për ndërmarrjet shtetërore, që rezultojnë me humbje, të përballohen brenda fondit të pagave, të miratuara nga ministria përkatëse.

8. Efektet financiare të indeksimit të pagave në organet e qeverisjes vendore të përballohen nga fondi i pagave, i miratuar nga këshillat e organeve të qeverisjes vendore.

9. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 77, datë 12.2.2004

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË AKREDITIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet "specialist", "përgjegjës sektori", "drejtor drejtorie" dhe "drejtor i përgjithshëm" në Drejtorinë e Akreditimit, të caktohen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1- diplomë e shkollës së lartë-është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) të jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikimin (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Akreditimit të paguhen sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

7. Ministrisë së Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri "paga dhe sigurime shoqërore", do t'i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për përballimin e efektit ekonomik për këtë vit.

8. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË AKREDITIMIT

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale			Shtesat e Pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
	1	2	3	4
Drejtori i Përgjithshëm	9 000	2%	0	74 000
Drejtor Drejtorie	9 000	2%	0	55 000
Përgjegjës Sektori	9 000	2%	0	40 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000

VENDIM
Nr. 78, datë 12.2.2004

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.404, DATË 19.6.2003 “PËR PËRBËRJEN,
FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E BORDIT TË GJEONFORMACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8907, datë 6.6.2002 “Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë” dhe të nenit 18 të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.404, datë 19.6.2003 të Këshillit të Ministrave, pas paragrafit “një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit” të shtohen edhe këta përfaqësues:

- “- një përfaqësues nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës anëtar
 - një përfaqësues nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme anëtar.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 80, datë 12.2.2004

**PËR PAGESËN E MJEKËVE, ANËTARË TË KOMISIONEVE MJEKËSORE TË
KONTROLLIT TË AFTËSIVE PËR SHËRBIMIN USHTARAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 37 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoritë e shëndetit publik dhe institucionet në varësi të tyre, në përputhje me rregulloren përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë, të vënë në dispozicion të qendrave të rekrutim-mobilizimit mjekë për kryerjen e detyrës funksionale të komisionit.

2. Të gjitha kontrollet dhe vaksinimet, për shtetasit që thirren në shërbimin ushtarak dhe ushtarakët, të bëhen falas dhe të evidentohen në dokumentacionin për shërbimin ushtarak.

3. Pas përfundimit të shërbimit ushtarak, në qendrën shëndetësore dërgohet një evidencë për problemet shëndetësore të shtetasit.

4. Mjekët, anëtarë të komisioneve mjekësore të kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore të qendrave të rekrutim-mobilizimit, për punën që bëjnë, të marrin shpërblim, si më poshtë vijon:

- kryetari 2 000 (dy mijë) lekë për çdo periudhë rekrutim-mobilizimi;
- anëtarët 1 800 (një mijë e tetëqind) lekë për çdo periudhë rekrutim-mobilizimi.

Pagesa e mjekëve, anëtarë të komisioneve mjekësore të qendrave të rekrutim-mobilizimit, të bëhet në qendrën përkatëse.

5. Mjekëve që janë anëtarë të komisionit mjekësor të kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit që thirret në shërbimin ushtarak dhe ushtarakut në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, për punën që kryejnë, t'u jepet shpërblimi, si më poshtë vijon:

- kryetar 2 000 (dy mijë) lekë në muaj;
- anëtarë 1 800 (një mijë e tetëqind) lekë në muaj.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimin nr.109, datë 2.2.1996 i Këshillit të Ministrave "Për funksionimin e komisioneve ushtarako-mjekësore të degëve të mobilizimit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr. 81, datë 12.2.2004

PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË SISTEMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10 pika 3.I, 72 pika 5.I shkronjat "a" dhe "b" të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të neneve 3 shkronja "e" 4, 6 shkronja "a" dhe të nenit 16 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2002 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1, 2 e 3 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen pronat e paluajtshme të sistemeve përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve, të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit dhe të koncesionit, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore me donatorët e huaj dhe shoqëritë kontraktuese.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë pronat sipas lidhjeve 1, 2 e 3 të këtij vendimi, janë të detyruara të ruajnë statusin juridik, të paktën për një periudhë 2-vjeçare.

4. Ministria e Ekonomisë të pasqyrojë ndryshimet e kapitaleve që vijnë si rezultat i transferimit të pronave të paluajtshme në njësitë e qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 2 dhe 3. Forma e administrimit për sistemet që transferohen të përcaktohet nga njësitë e qeverisjes vendore.

5. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore të kryejnë procedurat e regjistrimit të pronave, të miratuara në këtë vendim.

6. Detyrimet financiare të prapambetura, deri në çastin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore, të rregullohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

7. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, të pasqyrojë në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore për vitin 2004 fondet përkatëse për pagat, sigurimet shoqërore, subvencionet e investimet buxhetore për pronat e transferuara, duke iu referuar buxheteve përkatëse të viteve të mëparshme dhe akteve ligjore në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe donatorët e huaj, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ministrinë dhe institucionet qendrore përkatëse të hartojnë udhëzimet e përbashkëta në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Lidhja 1

Ndërmarrje të ujësjellësve dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen plotësisht

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
				VKM nr.dt.	Lista nr.
1.	Ujësjellës-kanalizime Fushë-Arrëz	Sh.a.	Bashkia Fushë-Arrëz	251 24.4.2003	2
2.	Ujësjellësi Vau i Dejës	Ndërm.	Bashkia Vau i Dejës	251 24.4.2003	15
3.	Ujësjellës-kanalizime, Ersekë	Sh.a.	Bashkia Ersekë	643 18.9.2003	3
4.	Ujësjellësi Novoselë	Ndërm.	Komuna Novoselë	643 18.9.2003	8

Lidhja 2

Ndërmarrje të ujësjellësve dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen plotësisht sipas sistemeve përbërës

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Nr.e sistemeve që transferohen	Referenca e miratim. invent.
1.	Ujësjellës kanalizime Pukë	Sh.a.	Bashkia Fushë-Arrëz	Sist. 4.5.6.7	VKM 251 24.4.2003 Lista II
2.	Ujësjellësi Bilisht	Sh.a.	Komuna Qendër Bilisht Komuna Hoçisht	Sist.2.3.4 Sist.5	VKM 366 5.6.2003 Lista 7
3.	Ujësjellësi Gjirokastër Ndërm.Fshat	Ndërm.	Komuna Lunxhëri Komuna Qendër, Libohovë Komuna Cepo Komuna Antigone	Sist.1.13 Sist 2.3.8 Sist.5.12,20 Sist.6.10,16,19	VKM 366 5.6.2003 Lista 14

Lidhja nr.3

Ndërmarrje të ujësjellësve dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen vetëm për sistemet përbërëse të identifikuar

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e qeverisjes vendore në të cilat transferohen	Nr.i sistemeve që transferohen	Referenca e miratim. invent.
1.	Ujësjellësi Malësi e Madhe	Sh.a.	Komuna Shkrel	Sist.3	VKM 251 24.4.2003 Lista 6
2.	Ujësjellësi Përmet	Sh.a.	Komuna Q.Piskovë	Sist.6	VKM 251 24.4.2003 Lista 9
3.	Ujësjellësi Skrapar	Sh.a.	Komuna Qendër	Sist.13,14,15,16,17,18,19	VKM 251 24.4.2003 Lista 13
4.	Ujësjellësi Vlorë	Sh.a.	Bashkia Selenicë Komuna Kotë	Sist.3 Sist.12,13	VKM 251 24.4.2003 Lista 16
5.	Ujësjellësi Bajram Curri	Sh.a.	Komuna Fierzë	Sist.4	VKM 366 5.6.2003 Lista 2
6.	Ujësjellësi Elbasan, Fshat	Sh.a.	Komuna Mollas	Sist.11	VKM 366 5.6.2003 Lista 5
7.	Ujësjellësi Korçë, Fshat	Sh.a.	Komuna Drenovë	Sist.1	VKM 643 18.9.2003 Lista 9

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1. KUSHTETUTA	600
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3. KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4. KODI PENAL	400
5. KODI I PUNËS	500
6. KODI I FAMILJES	450
7. KODI CIVIL	1000
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9. KODI ZGJEDHOR	355
10. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 25.2.2004

Tirazhi: 4500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë